




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT VLORE
SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE
CIVILE DHE KRIZAVE VENDORE

Nr. 615 Prot

Vlorë, më 19.04. 2019

MIRATOHET PREFEKTI I
QARKUT VLORE

FRAMUR MAMAJ



PLAN – MASASH

Për

**parandalimin e situatave të mundshme nga zjarret e krijuar si
pasoje e temperaturave të larta**

PRILL 2019

PLAN – MASASH

Për parapërgatitjen, parandalimin, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave të mundshme të emergjencave civile, gjatë stinës së verë - vjeshtë

Baza ligjore

1. Ligji nr. 107/2016, “Për prefektin qarkut”, 8,10,14
2. Ligjin 8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, neni 13,
3. VKM nr. 835, datë 03.12.2004 “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile”,
4. Urdhrit nr. 965, datë 02.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”

Të përgjithshme

Sezoni i stinës së verës dhe vjeshtës në Qarkun Vlorë, paraqet probleme të veçanta si pasojë e;

- rritjes së temperaturave të larta për një periudhë të gjatë, që ndryshojnë situatën në pyje dhe kullota, pemëtari, në zona rurale dhe urbane,
- mbipopullim në sezonin e verës veçanërisht në bregdet,
- shtim të fluksit të rritjes së automjeteve, lëvizja neglizhente e njerëzve në bregdet,
- neglizhenca në sjellje dhe reagim ndaj rreziqeve nga temperaturat e larta,
- rritje të mundësive të rënies së zjarreve në zonat industriale, sidomos në fushën e hidrokarbureve si pasojë e avullimit të lartë.

Pyjet dhe kullota në Qarkun e Vlorës, zënë një sipërfaqe prej rreth 40% të gjithë sipërfaqes totale të Qarkut Vlorë. Mos manazhimi i mirë i këtyre pasurive, ka bërë që gjatë sezonit të verës të vitit 2017, ketë vatra dhe provokime zjarresh në shumë vende. Numri i zjarreve nga shkaqe natyrore është shumë i vogël. Rastet e zjarreve janë pothuajse të gjithë nga ndërhyrje njerëzore qoftë aksidentale ose me dashje.

Në Qarkun Vlorë, ka pasur raste të shumta zjarresh të qëllimshme, për përfitimin e kullotave duke kërcënuar dhe zona të mbrojtura me vlera kombëtare. Shpenzimet për fikjen e zjarreve nga toka ose me ndërhyrje nga ajri kanë qenë shumë të mëdha gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2018 deri në fillim të muajit shtator pati pika zjarre (gjithsej 42 zjarre). Zjarret u shtuan gjatë muajit Mars 2019. Zjarret kanë qenë në përgjithësi për djegie të mbetjeve në parcelat bujqësore. Ka pasur 11 Raste të djegies së ullinjve për motive pronësie etj. Ka pasur 5 raste të djegies së makinave.

Marrja shpejt e sinjalit për zjarr dhe koordinimi për fikje, mbetet elementi kyç për fikjen shpejt të zjarreve dhe uljen e kostos për fikje.

Detyra, probleme, përgjegjësi, afate

Nr.	Detyra, probleme në vëmendje ose për tu trajtuar	Kush e ndjek	Afati	Vërejtje
1	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Plani i Masave ➤ Plani i Gatishmërisë ➤ Organizmi i takimeve me kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, shërbimit pyjor, zjarrfikës, specialistëve të Emergjencave Civile. ➤ Evidentimi nga administratorët lokal, të vatrave të rrezikuar për zjarre në plantacione me frutikulturë, për një kujdes të veçantë. ➤ Evidentimi i blegtorëve, zonat e patronazhit në pyje e kullota, tërheqja e vëmendjes për kujdesin dhe parandalimin e zjarreve. ➤ Evidentimi i kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve që kanë në dispozicion për kontribut për fikje zjarresh dhe gatishmëria e tyre për përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga zjarret në shkallë qarku. ➤ Marrja e masave tekniko-organizative me të gjitha institucionet e pushtetit vendor ose qendrorë me detyrimet për emergjencat. ➤ Të ripunohen të gjithë planet e emergjencave për sezonin, duke përfshirë në diskutim shoqërinë civile dhe komunitetin. ➤ Sensibilizimi i opinionit publik me të gjitha mjetet e komunikimit lokal, shpërndarjen fletë palosjeve etj., në mënyrë që të reagojnë të gjithë ndaj këtij fenomeni shumë të dëmshëm për mjedisin dhe aktivitetin njerëzor. ➤ Përcaktimi i saktë i detyrimeve për çdo institucion me varësi qendrore ose lokale për kontribut ndaj komunitetit në rast të emergjencave civile. ➤ Koordinimi dhe detyrimin që ka Institucioni i Prefektit për masa konkrete për rritjen e sigurisë publike në zonat turistike, në zonat industriale, në zonët me lëvizje të shumtë mjetesh etj. 	<p>SPPECKV (Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore</p>	<p>Deri 19.4</p> <p>05.06</p> <p>10.06</p> <p>20.05</p> <p>10.06</p> <p>10.06</p> <p>15.06</p> <p>Gjatë gjithë sesionit</p>	

2.	<p>➤ Prodhimi i fletës për planin e destiancion për rritjen e sensibilizimit të banoreve të zonave rurale, zonave turistike, fermerëve, blegtorëve, të nxënësve në shkolla.</p> <p>➤ Trajtimi i problemeve që kanë dalë në vite dhe specifikat për çdo zone (<i>anët pozitive dhe negative</i>). Mundësit për të reaguar sipas zonave dhe rasteve.</p> <p>➤ Ndërtimi i hartës ilustruese me zonat me rrezik zjarri dhe rrugët alternative për ndërhyrje. Fiksimi e azhurnimi i skemës së lajmërimit</p>	Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore	15.06 04.06	
3.	<p>➤ Njohja me udhëzimet e Kryeministrit, me rastin e akteve terroriste në Francë dhe Bruksel, Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 595, datë 14.04.2015 "<i>Për marrjen e masave për forcimin e ruajtjes dhe sigurisë kundër aktiviteteve terroriste</i>"</p> <p>➤ Njohja me të gjithë kapacitetet që kanë institucionet për kontribut në ngjarje të tilla.</p> <p>➤ Njohja e të gjithë institucioneve me varësi qendrore ose institucioneve lokale për detyrim që kanë në raste emergjencash të krijuara nga rënia e zjarreve.</p>		12.05 15.06	
4.	<p>Takimi për:</p> <p>➤ Zbatimin e detyrimeve të qeverisjes vendore, për përballimin e emergjencave në sezonin e verës</p> <p>➤ Punë që duhet bërë me grupet e interesit në bazë fshati, njësie administrative, "<i>Për reagimin në raste emergjencash të shkaktuara nga zjarri, nga të gjithë faktorët që duhet të kontribuojnë në zbatim të ligjit</i>".</p>	Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore		
5.	<p>Në zbatim të Ligjit 8756, datë 26.03.2001 "<i>Për Emergjencat Civile</i>"</p> <p>Organizimi i takimit të Komisionit Teknik Këshillimor Ndërinstitucional;</p> <p>Vlerësimi i situatës së përgjithshme.</p> <p>Vlerësim i situatës sipas rajoneve e zonave të qarkut</p> <p>Probleme dhe kapacitete të institucioneve sipas strukturës së tyre.</p> <p>Probleme dhe rekomandime për vendimmarrje</p>			
6.	<p>Krijimi i një bazë të dhënash për gatishmërinë e mjeteve</p> <p>Bashkëpunimin për marrje dhe dhënie</p>	20.05		

	informacioni në kohë me strukturat mbrojtëse të emergjencave civile, strukturat mbrojtëse të pyjeve, policisë së shtetit, forcave të armatosura, për të			
7.	Informimi në kohë për çdo ngjarje Koordinimi i mjeteve për të ndërhyrë në kohë, me eliminimin e incidenteve dhe zjarreve të mundshëm, në pyje kullota, në zonat rurale dhe ato në zonat urbane, turistike, industriale etj.			
8.			15.05	
9.	Përgatitja e numërorit telefonik përfshin: Drejtuesit e institucioneve Prefektin, nënprefektin, Specialistët e Emergjencave Civile në qark. Kryetarit të Qarkut Institucionet lokal Operator privat me mundësi kontributesh etj	Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore	20.05	
10.	Hartimi i planeve të bashkëpunimit të strukturave operacionale, zjarfikëse, sektor etj.	Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore		
11.	Situatat që mund të paraqiten në sezonin e verës, shkaku i zjarrit, përgjegjësit institucionale duke ju referuar detyrimit ligjor. Raportimi të jetë i menjëhershëm në Q.O.K.E.C	Sektori i Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore	15.05	
12.	Të evidentojnë të gjitha rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga zjarret Të hapet libri i evidentimit të emergjencave civile Të evidentohet shkaku i ndotjes Strukturat e angazhuara dhe zgjidhja e tyre. Anët pozitive të operacioneve Mangësitë dhe strukturat përgjegjëse Mos angazhimet dhe neglizhencat në veprim për plotësimin e detyrimeve. Analiza përfundimtare për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret.	Specialistët e Emergjencave Civile të Prefekturës së Qarkut Vlore		Në vazhdimësi

**Sektorit i Planifikimit, Përballimit të
Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore
Robert Skëndaj**

